

## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### SINDIKATA E PUNONJËSVE TË UNIVERSITETEVE TË SHQIPËRISË (SPUSH)

Rruga "Bilal Konxholli", Pallati "Dr. & Di", Kati I, Njesia Administrative nr. 8, Tiranë

INUS: L91623453V, Cel. 0693589216, e-mail: sindikata.spush@gmail.com

Nr. 292 Prot.

Tiranë, më 04/07/2020

### Thirrje për shtyrjen e zgjedhjeve në universitetet publike

Drejtuar:

Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Znj. Besa SHAHINI

Për dijeni:

Kryeministrit të Shqipërisë, SH.T.Z. Edi RAMA  
Presidentit të Republikës, SH.T.Z. Ilir META

1. Sindikata e Punonjësve të Universiteteve të Shqipërisë (SPUSH) i konsideron zgjedhjet në universitetet publike si përcaktuese për cilësinë e vetëqeverisjes dhe të ardhmen e tyre afatgjatë. Ajo gjykon se dhe sikur kuadri ligjor i arsimit të lartë të jetë i arrirë (çka nuk është), edhe sikur qeveria të rritë buxhetin dhe investimet në këtë sektor (çka është ende shumë i pamjaftueshëm), fati i zhvillimit të universiteteve përcaktohet më së pari nga cilësia e vetëqeverisjes dhe menaxhimit të tyre, d.m.th. nga legjitimiteti i drejtuesve të tyre përmes një procesi zgjedhor të rregullt, transparent e konform legjislacionit në fuqi.
2. Sindikata e Punonjësve të Universiteteve të Shqipërisë (SPUSH) i konsideron zgjedhjet në universitetet tona publike si një moment shumë të rëndësishëm për të bërë një analizë të efekteve të Ligjit të ri të Arsimit të Lartë (Nr. 80/2015), të ecurisë së reformave të ndërmarra në zhvillimin e universiteteve tona publike, si dhe të diskutimit të strategjive të zhvillimit afatmesëm dhe afatgjatë të tyre.
3. Sindikata e Punonjësve të Universiteteve të Shqipërisë (SPUSH) e konsideron zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme për autoritetet dhe organet drejtuese të universiteteve, sipas të gjithë standardeve të parashikuara në ligjin 80/2015 dhe statutet e rregulloret e universiteteve, si faktor përcaktues për rritjen e rolit të pedagogëve dhe studentëve në realizimin e autonomisë institucionale dhe vetëqeverisjes së universiteve.
4. SPUSH ka ndjekur në vijimësi situatën e krijuar si pasojë e vendimit të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr. 175, datë 30. 6. 2020, "Për zhvillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit



të lartë". SPUSH vëren se të gjitha problematikat e parashtuara në deklaratën e saj të datës 06.05.2020, ku kërkohej shtyrja e zgjedhjeve të qershorit 2020, por dhe arësyet për të cilat Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë firmosi Urdhrin Nr.108, datë 8.05.2020 "Për shtyrjen e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë...." janë akoma të pranishme e të pandryshuara, duke bërë në këtë mënyrë të pamundur zhvillimin e zgjedhjeve reale, të lira dhe të ndershme në universitetet publike, më 30 korrik 2020. Në këtë kontekst po parashtojmë problematikat më kryesore që ne konstatojmë:

- a) Këto zgjedhje në kohë pandemie dhe në mungesë të studentëve në universitetet publike, janë tërësisht formale, sepse ato nuk krijojnë asnjë premisë e mundësi reale për konkurrim të ndershëm dhe të paanshëm. Në kushtet kur numri i të prekurve me Covid-19 shtohet nga dita në ditë, hapja dhe zhvillimi i fushatës për zgjedhje presupozon takime dhe grumbullime studentësh e pedagogësh me kandidatët për dekanë dhe rektorë. Këta të fundit duhet të shpaleshin platformat e tyre për zhvillimin akademik të universiteteve. Një gjë e tillë është praktikisht e pamundur dhe e rrezikshme për shëndetin e pjesëmarrësve në takime, qofshin studentë apo pedagogë.
- b) Studentët nuk janë të pranishëm në universitete gjatë muajit korrik. Në zbatim të Urdhrit të Ministrit, nr. 104, datë 30.04.2020, vetëm studentët e vitit të tretë Bachelor dhe ata të vitit të dytë Master zhvillojnë provime gjatë muajit korrik. Tre kurset e tjera, përkatësisht kursi I dhe II Bachelor dhe kursi I Master i zhvillojnë konsultimet dhe provimet në muajt shtator dhe tetor. Nga një analizë që SPUSH u ka bërë orareve të provimeve në universitete të ndryshme rezulton se sezoni i provimeve në gjithë fakultetet mbaron më 25 korrik 2020, pra 5 ditë para zgjedhjeve, ndërkohë që disa universitete e fakultete (si Fakulteti i Gjuhëve të Huaja) po i zhvillojnë provimet on-line. Urdhri 104, datë 30.04.2020, detyron universitetet për : "... krijimin e mundësive për kthimin në auditor të studentëve të viteve të para dhe të viteve të ndërmjetme të të gjitha cikleve të studimit, për përsëritjen e leksioneve, seminareve apo punëve laboratorike, pas datës 25 gusht të vitit 2020, për një periudhë jo më pak se 4 javë". Kjo hedh poshtë konstatimin e Ministres Shahini se "... Sipas raportimeve që IAL<sup>-të</sup> kanë paraqitur për prezencën e studentëve në ambientet e tyre, muaji korrik do të ketë një numër të madh studentësh të pranishëm në provime."!!!
- c) Zhvillimi i zgjedhjeve në universitete në këtë periudhë nuk krijon mundësi reale të ushtrimit të së drejtës së votës së studentëve, në mënyrë të veçantë, atyre me banim jashtë qytetit dhe rrethit ku ndodhen universitetet. Si mund të shkojnë studentët nga rrethet për të votuar në universitetet e Tiranës apo ato rajonale? A mund të urdhërojë MASR kthimin e të gjithë studentëve në auditore vetëm për shkak të zgjedhjeve? A mund të organizojë MASR ose universitetet transportin e sigurtë të studentëve të rretheve për takime elektorale dhe në ditën e votimit në universitete?
- d) Ligji 80/2015 parashikon krijimin e mundësisë reale që çdo student të ushtrojë të drejtën e votës për rektorin, dekanin dhe përfaqësuesit e studentëve në Senatin e universitetit. Vota e studentëve zë 10 % të numrit total të votave për



zgjedhjen e autoriteteve të sipër cituara. Zhvillimi i zgjedhjeve në universitete në këtë periudhë të pandemisë dhe de facto pa pjesëmarrje reale të studentëve, nuk e përjashton mundësinë që vota e trupës zgjedhore studentore të keqpërdoret për një korrupsion të mundshëm zgjedhor. SPUSH ka bindjen e plotë që trupa zgjedhore studentore, në asnjë rast, nuk do të pranojë deformimin e vullnetit të tyre. Universiteti, si vend i dijes, duhet të promovojë modelet më të mira zgjedhore, duke braktisur haptazi modelet zgjedhore politike aktuale.

- e) Pretendimi i MASR se data e përcaktuar për zgjedhjet është kërkuar nga vetë rektorët e universiteteve nuk është argument, sepse trupa zgjedhëse në universitete janë pedagogët dhe studentët dhe jo drejtuesit e tyre. Ndërkohë të gjithë autoritetet drejtuese të universiteteve nuk kanë mandat legjitim pas datës 26 maj 2020. Në asnjë universitet nuk ka patur asnjë konsultim me Asambletë e pedagogëve dhe Këshillat studentorë për zhvillimin e zgjedhjeve në këtë datë. Ndërkohë, ka universitete ku janë shfaqur probleme reale dhe serioze për organizimin e zgjedhjeve në to (si për shembull Universiteti i Tiranës).

Nisur nga sa më sipër, Sindikata e Punonjësve të Universiteteve të Shqipërisë (SPUSH) i bën thirrje publike MASR që të rishqyrtojë Urdhrin Nr. 175, datë 30 qershor 2020, për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme ligjore për zgjedhje plotësisht legjitime, që garantojnë autoritete dhe organe drejtuese legjitime në universitetet tona publike.


Sindikata e Punonjësve të Universiteteve të Shqipërisë (SPUSH) është e bindur dhe paralajmëron se zhvillimi i zgjedhjeve fiktive në universitetet publike do të prodhojë autoritete drejtuese fiktive, thuajse të emëruara, por jo të zgjedhura, që do të jenë jo legjitime, çka do të ketë pasoja shkatërrimtare për zhvillimin e universiteteve publike dhe do të asgjësojë autonominë e tyre institucionale të garantuar me Kushtetutë. Ne jemi të bindur se zgjedhje të tilla në universitete nuk u shërbejnë studentëve, pedagogëve dhe shoqërisë sonë në tërësi.

Sindikata e Punonjësve të Universiteteve të Shqipërisë (SPUSH) shprehet e gatshme të bashkëpunojë me MASR, Asambletë Akademike dhe Këshillat Studentorë të universiteteve publike për të zhvilluar zgjedhje universitare, të lira dhe të ndershme, sipas të gjitha standardeve që parashikon ligji 80/2015, në një kohë tjetër që krijon kushte optimale për zhvillimin e tyre. Ne propozojmë se koha më e përshtatshme për zhvillimin e zgjedhjeve në universitetet publike është **java e katërt e semestrit dimëror 2020-2021**, gjithnjë, nëse realizohen kushtet e një procesi normal zgjedhor.

## NË EMËR TË SINDIKATËS SË PUNONJËSVE TË UNIVERSITETEVE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Prof. asoc.dr. Enkelelda OLLDASHI



KRYETARI

Prof. asoc.dr. Sandër KOVAÇI

